

NJOFTIM PUNE

Profili i kompanisë:

Balkan Finance Investment Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

Mane TCI është pjesë e Balfin Group e specializuar në ndërtim.

Pozicioni: Inxhinier Zbatimi

Departmenti: Teknik

Vendodhja: Palas ,Vlorë

Përmbledhja e Pozicionit:

Inxhinieri i Kantierit zbaton direktivat e Drejtuesit të Kantierit dhe kontrollon punimet në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe KTZ, dhe kushteve të sigurisë & shendetit në punë.

Detyra dhe Përgjegjësi :

- Hartimin dhe ndjekjen e grafikut të punimeve sipas projektit dhe planit të organizimit
- Përpilimin dhe kontrollin e të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor në objekt, si ditar objekt, proces-verbale, libreza masash, situacione, akte piketimi e kontrolli etj.
- Kontrollin e cilësisë dhe çështjet e sigurisë në kantier, si dhe sigurohet se të gjitha rregullat po zbatohen sipas rregullores të menaxhim QA/QC dhe HSE si dhe ligjeve në fuqi.
- Aprovimin e materialeve që implementohen në kantier.
- Sigurimin e zbatimit të punimeve në përputhje me politikën e menaxhimit të cilësisë të kompanisë.
- Marjen në dorëzim të punimeve të zbatimit, kryerjen e Inspektimeve të rregullta
- Përgatitjen e "snagging list" ose të punimeve me mangësi ose të papërfunduara si pjesë e procesit të kolaudimit
- Zbatimin me rigozitet të kontratave të sipermarrjes
- Zbatimin me rigozitet i rregullave teknike dhe kodit të veshjes
- Organizimin dhe Kordinimin me stafin në varësi (teknik, brigadier , hidraulik , elektrikist, topograf) për punime në kantier
- Kordinimin e programit të punës midis kontraktoreve, aty ku puna e tyre nderthuret në faza të caktuara.
- Evidentimin e nevojave për materiale, dhe mirë administrimin e tyre, të makinerive dhe të fuqisë punëore.

- Përgatitjen e raporte ditore, javore me problematika dhe ecurinë përkatëse.

a. Edukimi:

Të zotërojë diplomë universiteti në Inxhinieri Ndërtimi.

b. Eksperiencat e punës:

Të ketë experiencë pune 5 deri në 7 vjet.

c. Kualifikime të tjera:

- Aftësi për të lexuar, analizuar dhe shpjeguar projektet, korrespondecat e biznesit, kontrata, procedurat dhe manualet teknike.
- Aftësi për të menaxhuar projekte dhe kontrakta të ndryshme specifike që përfshihen në projekte ndërtimi
- Aftësi për të prezantuar në mënyrë sa më efektive problematikat, komunikim i shkëlqyer me gojë dhe me shkrim ,përgatitje raportesh etj.
- Të ketë iniciative dhe fleksibilitet lidhur me orarin e punës.
- Principet dhe praktikat në përdorimin e programeve kompjuterike (CAD, EXCEL, MS-PROJECT (ose PRIMAVERA) etc.)

d. Aftësi të tjera:

- Aftësi shumë të mira menaxhuese, organizative, planifikuese, projektuese dhe komunikuese
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (njohja e një gjuhe tjetër të komunitetit europian do të përbënë avantazh)

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-të e tyre në adresën hr@manetci.al me subjekt MTCL_1018 ose duke plotësuar Formularin e Aplikimit në faqen zyrtare të Mane TCI @ <http://manetci.al/al/karriera/formular-aplikimi>

Afati i dorëzimit: 16 Maj 2018

Vetëm kandidatet e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.